



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1449/1 Prot.

Tiranë, më 17.07. 2026

V E N D I M

Nr. 111 dt. 17.07 2026

“PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT TË GRUPIT TË PUNËS, NGRITUR ME URDHRIN E REKTORIT TË UST “PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR VERIFIKIMIN E PROCEDURËS SË NDJEKUR PËR NXJERRJEN DHE EKZEKUTIMIN E URDHRAVE NR. 47, DATË 15.05.2026, “PËR MARRJEN E MASAVE PËR NDALESËN E PAGESAVE TË KRYERA PËR KATEGORINË ASISTENT LEKTOR” DHE NR. 62, DATË 03.06.2026, “PËR MARRJEN E MASAVE PËR NDALESËN E PAGESAVE TË KOMISIONEVE NË ZBATIM TË REKOMANDIMEVE TË AUDITIT TË BRENDSHËM”.

Mbështetur në nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në neni 20 të Statutit të UST-së, në nenin 7 të Rregullores së Universitetit të Sporteve të Tiranës, në shkresën nr. 3021/36 Prot., datë 16.07.2026 Raport i grupit të punës ngritur me Urdhrin nr. 21, datë 14.07.2026 të Rektorit të UST “Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e procedurës së ndjekur për nxjerrjen dhe ekzekutimin e urdhreve nr. 47, datë 15.05.2026, “Për marrjen e masave për ndalesën e pagesave të kryera për kategorinë asistent lektor” dhe nr. 62, datë 03.06.2026, “Për marrjen e masave për ndalesën e pagesave të komisioneve në zbatim të rekomandimeve të auditit të brendshëm”, Raportin e Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Arsimit protokolluar në UST me nr. 3021/5 Prot., datë 02.04.2026, Vendimin e Senatit Akademik nr. 108, datë 13.07.2026 “Për mbështetjen e kërkesave të parashtruara në petitionin me nr.3021/32 datë 10.07.2026”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 17.07.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Raportit të Grupit të Punës mbi verifikimin e procedurës së ndjekur për nxjerrjen dhe ekzekutimin e urdhreve nr. 47, datë 15.05.2026, “Për marrjen e masave për ndalesën e pagesave të kryera për kategorinë asistent lektor” dhe nr. 62, datë 03.06.2026, “Për marrjen e

masave për ndalesën e pagesave të komisioneve në zbatim të rekomandimeve të auditit të brendshëm” (bashkëlidhur).

2. T'i propozojë Bordit të Administrimit të UST shfuqizimin e Urdhrit nr. 47, datë 15.05.2026 "Për marrjen e masave për ndalesën e pagesave të kryera për kategorinë Asistent Lektor" dhe të Urdhrit nr. 62, datë 03.06.2026 "Për marrjen e masave për ndalesën e pagesave të komisioneve në zbatim të rekomandimeve të Auditit të Brendshëm", si akte të papajtueshme me vendime të mëparshme të Bordit të Administrimit me të njëjtin objekt dhe të shoqëruara me parregullsi në procedurën e ekzekutimit.
3. Ky Vendim i përcillet Bordit të Administrimit, njësisë të UST-së, si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA



RAPORT I GRUPIT TË PUNËS


NGRITUR ME URDHËR NR 21, DATË 14.07.2026 TË REKTORIT TË UST “PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR VERIFIKIMIN E PROCEDURËS SË NDJEKUR PËR NXJERRJEN DHE EKZEKUTIMIN E URDHRAVE NR. 47, DATË 15.05.2026, “PËR

MARRJEN E MASAVE PËR NDALESËN E PAGESAVE TË KRYERA PËR KATEGORINË ASISTENT LEKTOR” DHE NR. 62, DATË 03.06.2026, “PËR MARRJEN E MASAVE PËR NDALESËN E PAGESAVE TË KOMISIONEVE NË ZBATIM TË REKOMANDIMEVE TË AUDITIT TË BRENDSHËM”.

Objekti:

Verifikimi i procedurës së ndjekur për nxjerrjen dhe ekzekutimin e Urdhrave nr. 47, datë 15.05.2026 “Për marrjen e masave për ndalesën e pagesave të kryera për kategorinë Asistent lektor” dhe nr. 62, datë 03.06.2026 “Për marrjen e masave për ndalesën e pagesave të komisioneve në zbatim të rekomandimeve të auditit të brendshëm të MA”

Grupi i Punës:

Dhurata Bozo – Kryetare	IKSHS	
Elton Spahiu – Anëtar	FVFR	
Enkeleda Lleshi – Anëtare	FSHL	
Aisel Oseku – Anëtare	FSHR	
Lindita Cakoni – Anëtare	Përfaqësuese - Drejtorja Juridike	

I - METODOLOGJIA E PËRDORUR

Grupi i punës, i ngritur me Urdhër nr. 21, datë 13.07.2026, të Rektorit të UST, për të kryer verifikimin në zbatim të vendimit në fjalë, shqyrtoi sa më poshtë:

1. Raportin e Auditit të Brendshëm të MA, Nr. 1847/1 Prot, datë 30/03/2026, “Dërgim i Raportit përfundimtar të auditimit”, hyrje në UST, Nr. 3021/5, datë 02.04.2026.
2. Shqyrtoi Urdhrat nr. 47, datë 15.05.2026 “Për marrjen e masave për ndalesën e pagesave të kryera për kategorinë Asistent-Lektor” dhe Urdhërin Nr. 62, datë 03.06.2026 “Për marrjen e masave për ndalesën e pagesave të komisioneve në zbatim të rekomandimeve të Auditit të Brendshëm të MA”.

4. Kërkoj zyrtarisht Zyrës së Arkivë-Protokollit të UST përmes Shkresës Nr. 3021/34, datë 14/07/2026 vënien në dispozicion të Shkresave e serisë me Nr. 3021 (1-32) dhe Shkresat e serisë me Nr. 1178 (1 - 18) që lidhen me ekzekutimin e urdhërave objekt i këtij raporti.
5. Hartoi Raportin në lidhje me të gjitha pikat e sipërpërmendura, shoqëruar me Përfundimet e Rekomandimet, duke bashkëlidhur dokumentat zyrtare dhe evidencat e shqyrtuara në këtë proces.

I gjithë dokumentacioni i shqyrtuar për hartimin e këtij Raporti është pjesë e Aneksëve, që janë organizuar e grupuar sipas rendit të trajtimit të tyre në seksionin Gjetjet e Grupit të Punës. Bashkëngjitur Aneksët 1.

II – GJETJET E GRUPIT TË PUNËS

Referuar akteve ligjore e nënligjore në fuqi, Grupi i Punës shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e sipërcituar, kreu verifikimin e kërkuar në respektim të Vendimit Nr. 21, datë 14/06/2026 të Rektorit të UST, në përfundim të të cilit konstaton dhe evidenton sa më poshtë:

1. Procedura e nxjerrjes së Urdhërave

- *Procedura e nxjerrjes së Urdhërit Nr. 47, datë 15.05.2026 i Administratores së UST*


Ky urdhër parashikon detyrimin dhe kthimin e pagesave për disa (7) anëtarëve të personelit akademik të UST të kategorisë “Lektor” të përfituara nga viti 2019 e në vazhdim.

Nga shqyrtimi i këtij urdhëri dhe disa Vendimeve të Bordit të Administrimit që lidhen me objektin e këtij urdhëri, Grupi i Punës konstaton se:

Urdhëri është nxjerrë me qëllim zbatimin e Rekomandimit Nr. 5 të Raportit të Auditit të MA. Në fakt, sipas vetë Raportit të Auditimit, Rekomandimi 4.2, kjo përgjegjësi i është ngarkuar UST në bashkëpunim me Bordin e Administrimit. Ky rekomandim është reflektuar për pasojë edhe në Planin e Veprimit të UST ndaj rekomandimeve të auditit, dërguar MA dhe instancave të UST nga Administratori. Edhe në këtë dokument zyrtar përgjegjësi për rishikimin e statusit/kategorisë së personelit dhe pagesave përkatëse i janë lënë Bordit të Administrimit. Në të njëjtën kohë, urdhëri Nr. 47, datë 15.05.2026 bie në kundërshtim/shkelje të disa vendimeve të Bordit të Administrimit për personat që u është dhënë statusi “Lektor” (Vendimit Nr.38, datë 02.12.2019, Vendimin Nr. 56, datë 30.11.2022 dhe Vendimin Nr 58, datë 12.12.2023 të Bordit të Administrimit). Këto Vendime janë ende në fuqi pasi as nuk janë ndryshuar apo shfuqizuar para nxjerrjes së urdhërit në fjalë. (bashkëlidhur Aneksët 2).

Përsa i përket rolit të Bordit të Administrimit në këtë çështje, në dokumentacionin që arritëm të disponojmë nuk u gjet asnjë dokument apo akt zyrtar apo ndonjë vendimmarrje e Bordit të Administrimit kundrejt apo për zbatim të Rekomandimeve të Raportit të Auditimit dhe Planit të Veprimit të UST ndaj rekomandimeve. Kësisoj, Urdhëri i Administratorit për këtë çështje nuk është mbështetur në asnjë vendimmarrje të re nga ana e Bordit të Administrimit për shkak të mosveprimit të tij, por është nxjerrë si një urdhër i drejtpërdrejtë në zbatim të Rekomandimeve/Planit të Veprimit të Raportit të Auditimit.

2



Nga ana tjetër, mosveprimi i Bordit të Administrimit në lidhje me statusin e kategorisë “Lektor” për këta antarë të personelit akademik dhe pagesat përkatëse është i pajustificuar. Në Raportin e Auditimit, në Rekomandimin Nr. 4.2, kërkohet në mënyrë eksplicite që UST në bashkëpunim me Bordin të Administrimit të rishikojë menjëherë klasifikimin e kategorive të personelit dhe të pagesave për personelin në fjalë. Kjo është reflektuar dhe në Planin e Veprimit dërguar edhe BA, ku këto përgjegjësi i janë caktuar këtij të fundit. Ndaj, mosveprimi i Bordit për këtë çështje, përveçse ka krijuar një problematikë serioze, dëshmon dhe për mosmarrje të përgjegjësi institucionale e vendimmarrëse nga ana e tij.

Për këtë arsye Grupi i Punës nxjerr përfundimin se:

Urdhëri Nr. 47, datë 15.05.2026 i Administratores së UST, nuk mbështetet në një vendimarrje të BA dhe bie në kundërshtim me vendime të mëparshme Bordit të Administrimit ende në fuqi.

Ky urdhër është nxjerrë në zbatim të një rekomandimi të Raportit të Auditimit të MA por që sipas vetë këtij Raporti dhe Planit të Veprimit, dërguar Ministrisë së Arsimit përgjegjësia që lidhet me rishikimin e kategorisë së personelit dhe pagesat janë kompetencë dhe përgjegjësi e BA të UST.

Bordi i Administrimit, nuk ka nxjerrë asnjë akt rregullator në lidhje me këtë rekomandim të Raportit të Auditimit të MA dhe Planit të Veprimit të UST, duke mos ushtruar kompetencat dhe në bazë të të gjithë kuadrit rregullator në fuqi dhe në zbatim të përgjegjësive të tij ligjore. BA duhet të vijonte me shqyrtimin e rekomandimit në lidhje me pagesat e marra nga personat që kanë fituar statusin “Lektor”, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

• *Procedura e nxjerrjes së Urdhërit Nr. 62, datë 03.06.2026 i Administratores së UST*

Ky urdhër parashikon detyrimin dhe kthimin e pagesave për disa (16) anëtarëve të personelit akademik dhe studentë të UST, anëtarë të dy Komisioneve të Senatit Akademik, konkretisht Komisionit të Sigurimit të Cilësisë dhe Kurrikulave dhe Komisionit të Marrëdhënieve me Studentët, të ngritura në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi dhe Statutit të UST.

Urdhëri Nr. 62, datë 03.06.2026 është nxjerrë, sikurse citohet, në zbatim të rekomandimit 4 të Raportit të Auditimit të MA. Por sikurse për urdhërin më lart, edhe këtu konstatohet problematikë shumë e ngjashme Sipas Raportit të Auditimit, Rekomandimi 4.1, i kërkohet në mënyrë eksplicite vetëm Bordit të Administrimit të rishikojë vendimet për miratimin e tarifave të pagesave të këtyre komisioneve. Ky përcaktim është reflektuar për pasojë edhe në Planin e Veprimit të UST ndaj rekomandimeve të auditit, dërguar MA dhe instancave të UST nga Administratori. Në këtë dokument zyrtar përgjegjësia për rishikimin e statusit/kategorisë së personelit dhe pagesave përkatëse i lihen nën përgjegjësi eksplicite Bordit të Administrimit. Përveç kësaj, urdhëri Nr. 62, datë 03.06.2026 është në kundërshtim të Vendimit Nr.33, datë 23.06.2021 të Bordit të Administrimit që miraton tarifat dhe pagesat e këtyre komisioneve, ende në fuqi.

Në lidhje me këtë çështje, Bordi i Administrimit ka reaguar ndaj Raportit të Auditimit duke nxjerrë Vendimin e tij Nr. 40, datë 29.05.2026, propozuar nga Senati Akademik përmes Vendimit Nr. 84, datë 29.05.2026 të këtij të fundit. Të dy vendimet kanë si objekt “Pezullimin e Veprimtarisë së dy komisioneve të përhershme. Por në asnjën prej tyre nuk shprehen për veprime apo akte nënligjore në lidhje me pagesat apo ndalesën e tyre dhe as nuk e nënkuptojnë këtë. Ndaj edhe në këtë rast, Urdhëri i nxjerrë nga Administratori nuk mund të konsiderohet i mbështetur në këtë vendim të Bordit pasi ai vetëm pezullon veprimtarinë dhe për pasojë (nënkupton) mos-dhënien e pagesave por që nga momenti

i pezullimit e jo përpara nxjerrjes së vendimit. Në lidhje me reagimin apo vendimmarrje të tjera të Bordit të Administrimit ndaj Raportit të Auditit të MA, shtojmë se në dokumentacionin e grumbulluar nuk gjetëm asnjë akt tjetër zyrtar i nxjerrë prej tij për këtë çështje. Kështu, edhe për këtë urdhër, Urdhëri i Administratorit nuk mbështetet në asnjë vendimmarrje të Bordit mbi çështjen në fjalë (ndalesën e pagesave), dhe rezulton në shkelje të një vendimit të mëparshëm të tij me të njëjtin objekt (bashkëngjitur aktet përkatëse – Aneksat 3).

Nga ana tjetër, mosveprimi i Bordit të Administrimit për nxjerrjen e një akti zyrtar në lidhje me tarifat dhe pagesat e dy komisioneve është i pajustificuar. Në Raportin e Auditimit, në Rekomandimin Nr. 4.1, kërkohet në mënyrë eksplicite që Bordi i Administrimit të rishikojë vendimet për miratimin e tarifave të pagesave të antarëve të këtyre komisioneve, e shprehur gjithashtu në Planin e Veprimit të UST. Vendimi Nr 40, datë 29.05.2026 i Bordit, përvec pezullimit të Komisioneve, nuk sjell asnjë rregullim të ri në përgjigje ndaj përgjegjësive të tij për këtë çështje, duke krijuar përsëri një boshllëk nënligjor serioz dhe duke dëshmuar mungesë vullneti për marrje të përgjegjësive institucionale e ligjore nga ana e tij. (bashkëngjitur Aneksat 4)

Për këtë arsye Grupi i Punës nxjerr përfundimet e mëposhtme:

Urdhëri Nr. 62, datë 03.06.2026, nuk mbështetet në një vendimmarrje të posacme të BA dhe në të njëjtën kohë bie në kundërshtim me vendime të mëparshme Bordit të Administrimit.

Ky urdhër është nxjerrë në zbatim të një rekomandimi të Raportit të Auditimit të MA por që sipas vetë këtij Raporti dhe Planit të Veprimit, dërguar Ministrisë së Arsimit, përgjegjësia që lidhet me rishikimin e tarifave dhe pagesave të dy komisioneve janë kompetencë dhe përgjegjësi eskuzive e BA.

Bordi i Administrimit, nuk ka vepruar sipas detyrimeve të tij ligjore, duke mos ushtruar kompetencat dhe duke mos nxjerrë asnjë akt nënligjor të posacëm në lidhje me këtë rekomandim të Raportit të Auditit të MA, apo detyrimeve sipas Planit të Veprimit të UST. BA duhet të vijonte me shqyrtimin e rekomandimit në lidhje me pagesat e marra nga anëtarët e komisioneve, në bazë të të gjithë kuadrit rregullator në fuqi dhe mbështetur në faktin që komisionet janë ngritur dhe kanë funksionuar në zbatim të dispozitave të Statutit të UST, miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin.

2. Procedura e ekzekutimit të Urdhërave

• Procedura për ekzekutimin e Urdhërit Nr. 47, datë 15.05.2026

Për verifikimin e kësaj procedure u morën në shqyrtim Shkresat Zyrtare regjistruar në protokoll me seri të Nr. 3021 Prot. (3021/17 – 3021/32), gjatë periudhës kohore 25.06.2026 – 10.07.2026. Deklarojmë se në lidhje me këtë çështje nuk u gjet asnjë dokumentacion tjetër zyrtar që nga hyrja e Raportit të Auditit në UST deri në momentin e hartimit të këtij raporti.

Shkresat me Nr. 3021/18 deri 3021/24 janë njoftime të Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit të UST drejtuar 7 anëtarëve të personelit të brendshëm të UST me objekt “Njoftim mbi detyrimet e konstatuara sipas Rekomandimit nr.5 të Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Arsimit”.

Shkresat me Nr. 3021/25 deri 3021/31 janë kundërshtime të personave të prekur nga urdhëri ndaj njoftimeve mbi detyrimet e pretenduara dërguar nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të UST nga 7 anëtarët e personelit akademik.

Shkresa Nr. 3021/32, datë 10.07.2026 e kësaj serie, është një peticion drejtuar Senatit Akademik të UST me objekt "Peticion për shqyrtimin e njoftimeve mbi detyrimet e pretenduara ndaj stafit dhe studentëve, garantimin e të drejtës për informim dhe dëgjim, mbrojtjen e pagës, pezullimin e cdo veprimi financiar, nisjen e hetimit administrative dhe trajtimin e cështjes edhe si sinjalizim administrativ", i paraqitur dhe diskutuar në mbledhjen e Senatit Akademik të datës 13.06.2026.

Nga dokumentacioni i shqyrtuar mbi procedurën e ekzekutimit të këtij urdhëri konstatohet se i gjithë komunikimi zyrtar me personat "të prekur nga urdhëri" të lidhur me Urdhërin në fjalë konsiston vetëm në njoftimet e sipërpërmendura drejtuar këtyre personave dhe përgjigjeve të tyre ku kundërshtojnë këto njoftime në lidhje me detyrimin për kthim të pagesave dhe pretendime për mosrespektim të detyrimeve procedurave ligjore përkatëse.

Deklarohet gjithashtu se Grupi i Punës nuk gjeti asnjë komunikim tjetër, informim paraprak apo njohje me aktet apo dokumentat ku mbështetet urdhëri dhe ekzekutimi fundor i tij.

Bashkëngjitur Aneksat 5.

a. Procedura e ndjekur në lidhje me kthimin e pagesave të përfituara

Në kuadër të shqyrtimit të procedurës së nxjerrjes së urdhrit dhe procedurës së ndjekur për kthimin e pagesave, Grupi i Punës konstatoi se pagesat objekt shqyrtimi janë kryer mbi bazën e akteve të UST-së, të miratuara nga organet kolegjiale dhe autoritetet drejtuese sipas kompetencave përkatëse. Këto akte kanë prodhuar efekte juridike dhe financiare dhe janë zbatuar nga institucioni për një periudhë disavjeçare.

Gjatë analizës së procedurës së ndjekur, Grupi i Punës mori në konsideratë edhe dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative që rregullojnë aktet administrative dobiprurëse dhe efektet e tyre. Në këtë kuadër, neni 113 i Kodit parashikon dallimin ndërmjet anulimit dhe shfuqizimit të aktit administrativ, ndërsa neni 114 rregullon kushtet dhe kufizimet për anulimin e akteve administrative dobiprurëse në rastet kur pala përfituese është në mirëbesim. Neni 114 parashikon se: "Nëse pala përfituese është në mirëbesim, një akt administrativ dobiprurës i paligjshëm, nuk mund të anulohet, por vetëm mund të shfuqizohet.

Nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton që, për aktet mbi bazën e të cilave janë kryer pagesat, të jetë marrë një vendim për anulimin ose shfuqizimin e tyre sipas procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Grupi i Punës vlerëson se këto elemente përbëjnë rrethana procedurale që duhen marrë në konsideratë në analizën e procedurës së ndjekur për nxjerrjen e urdhrit dhe për kërkimin e kthimit të pagesave.

b. Procedura e ndjekur për ekzekutimin e urdhërit

Në lidhje me këtë pikë rezulton se në rastin konkret, personat "të prekur nga urdhëri", pa asnjë njoftim të mëparshëm zyrtar, janë vendosur në mënyrë të menjëhershme përballë kërkesës për kthim të shumave të pretenduara si detyrim ndaj UST, pa ushtruar të drejtën ligjore për t'u njohur me aktet, raportet, urdhrat, relacionet dhe vlerësimet juridike mbi të cilat UST mbështet pretendimin për detyrim (Neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë).

Përveç kësaj, Neni 33 i Kushtetutës garanton të drejtën për t'u dëgjuar përpara marrjes së një vendimi që prek të drejtat dhe interesat e personit. Në rastin konkret, personat përveçse janë vendosur përballë shumave të pretenduara si detyrim, u është kërkuar të pranojnë kthimin e tyre madje duke "pranuar kthimin në mënyrë vullnetare" dhe pa u dëgjuar më parë apo pa patur mundësi efektive për mbrojtje. Për më tepër, neni 44 i Kushtetutës garanton të drejtën për rehabilitim dhe/ose zhdëmtim në rast dëmi të shkaktuar nga një akt, veprim ose mosveprim i paligjshëm i organeve shtetërore.

Procedura e ndjekur më lart paraqet problematika referuar edhe Kodit të Procedurave Administrative (KPA). KPA kërkon që veprimtaria administrative të zhvillohet në respektim të ligjshmërisë, transparencës, arsytimit, proporcionalitetit dhe të drejtës së palës për t'u dëgjuar. Neni 99 i KPA, për aktin administrativ të shkruar, kërkon që akti të ketë përmbajtje të qartë, bazë ligjore, arsytim, dispozitiv, datën e hyrjes në fuqi dhe të drejtën e ankimit. Po ashtu, neni 165 i KPA parashikon se organi publik nuk mund të kryejë veprime ekzekutimi, përveçse në zbatim të një akti administrativ që është bërë i ekzekutueshëm sipas Kodit. Në rastin konkret, njoftimet për detyrime financiare nuk përmbajnë analizën e domosdoshme për krijimin e një detyrimi individual, nuk shpjegojnë se cili akt konkret i mëparshëm është anuluar ose shfuqizuar, nuk tregojnë nëse aktet mbi bazën e të cilave janë kryer pagesat janë konsideruar të pavlefshme, nuk analizojnë nëse këto akte kanë qenë akte dobiprurëse, nuk analizojnë nëse 'të prekur nga urdhërit' kanë qenë përfitues në mirëbesim, se si mund të kërkohej kthimi i pagesave të konsumuara si page dhe nuk përcaktojnë mjetin, organin dhe afatin e ankimit.

Neni 104, pika 4/a e KPA parashikon se një akt administrativ sjell pasoja juridike:

a) për sa kohë nuk është anuluar apo shfuqizuar, kryesisht apo si rezultat i ushtrimit të mjeteve ligjore administrative ose gjyqësore.

Në veçanti, nenet 40-48 KPA-së, garantojnë të drejtën e palëve për tu përfshirë në proces, për t'u dëgjuar përpara marrjes së një vendimi e për të paraqitur mendime, shpjegime, prova nëse disponojnë. Një njoftim financiar ku palët vendosen përballë një shume të pretenduar dhe ftohen të nënshkruajnë akt-marrëveshje nuk zëvendëson as këto të drejta kushtetuese dhe as kërkesat e procedurës administrative. Ndaj, në mungesë të një procedure të tillë dhe të një vendimi përfundimtar të rregullt, shkresat e financës nuk mund të trajtohen si akte përfundimtare që krijojnë detyrim personal përfundimtar ndaj individëve që preken nga Urdhëri i Administratorit.

Nga pikpamja formale, neni 98 dhe vijues i KPA përcakton se aktet administrative konsiderohen të vlefshme kur hartohen konform kriterëve e kërkesave të formës dhe arsytimit të aktit administrativ. Ndaj çdo akt, përfshirë ato që krijojnë detyrim financiar ndaj individëve, duhet të përmbajnë bazën ligjore, arsytimin, dispozitivin, kohën e hyrjes në fuqi dhe të drejtën e ankimit. Gjithashtu ai duhet të shpjegojë situatën faktike, rezultatin e rrugës administrative, vlerësimin e provave, bazën ligjore dhe arsyen pse përmbushen kushtet ligjore për ngarkimin me detyrim secilin rast individual. Faktikisht, këta elementë mungojnë në Urdhërin e ndalesës së pagesave dhe njoftimet individuale në zbatim të tij.

Mbështetur në sa më lart, Grupi i Punës nxjerr përfundimet e mëposhtme:

Në njoftimin drejtuar personave të prekur nga urdhëri janë anashkaluar një sërë hapash e fazash të detyruara ligjore të sanksionuara në Kushtetutën e RSH dhe Kodin e Procedurave Administrative të RSH.

Në procedurën e ndjekur gjatë ekzekutimit të Urdhërit Nr. 47, datë 15.05.2026 konstatohen një parregullsi që lidhen me mosrespektimin e disa të drejta të ligjshme të personave të prekur, duke anashkaluar edhe faza proceduriale të detyruareshme.

• Procedura për ekzekutimin e Urdhërit Nr. 62, datë 03.06.2026

Për verifikimin e kësaj procedure u morrën në shqyrtim Shkresat Zyrtare regjistruar në protokoll me seri të Nr. 1178 Prot. (1178/I-18), gjatë periudhës kohore 03/06/2026 deri 10/07/2026. Deklarojmë se në lidhje me këtë çështje, përveç këtij dokumentacioni, nuk u gjet asnjë dokumentacion tjetër zyrtar që nga hyrja e Raportit të Auditit në UST deri në momentin e hartimit të këtij raporti.

Shkresat me Nr. 1178/2-17 janë njoftime të Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit të UST drejtuar 16 antarëve të personelit të brendshëm të UST dhe studentë me objekt “Njoftim mbi detyrimet e konstatuara sipas Rekomandimit nr. 6 të Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Arsimit”.

Shkresa Nr. 1178/18, datë 10/07/2026 e kësaj serie, është një Shkresë e 16 personave drejtuar disa instancave të UST, përfshirë Senatin Akademik me lëndë “Kundërshtim i njoftimeve mbi detyrimet e pretenduara, kërkesë për venien në dispozicion të dokumentacionit të plotë dhe zhvillimin e një verifikimi administrative, financiar dhe juridik”, i paraqitur dhe diskutuar në mbledhjen e Senatit Akademik të datës 13/06/2026.

Nga dokumentacioni i shqyrtuar mbi procedurën e ekzekutimit të këtij urdhëri konstatohet se i gjithë komunikimi zyrtar me personat “të prekur nga urdhëri” të lidhur me Urdhërin në fjalë konsiston vetëm në njoftimet e sipërpërmendura drejtuar këtyre personave dhe përgjigjeve të tyre ku kundërshtojnë këto njoftime në lidhje me detyrimin për kthim të pagesave dhe pretendime për mosrespektim të detyrimeve procedurave ligjore përkatëse.

Deklarojmë gjithashtu se Grupi i Punës nuk gjeti asnjë komunikim tjetër, informim paraprak apo njohje me aktet apo dokumentat ku mbështetet urdhëri dhe ekzekutimi fundor i tij. Bashkëngjitur Aneksat 6.

a. Procedura e ndjekur në lidhje me kthimin e pagesave të përfituara

Arsyetimi dhe argumentimi për këtë pikë është i njëjtë me atë të Pikës a, *Procedura e ndjekur në lidhje me kthimin e pagesave të përfituara të Urdhërit Nr. 47, datë 15.05.2026 më lart.*

b. Procedura e ndjekur për ekzekutimin e urdhërit

Në lidhje me procedurën e ndjekur për ekzekutimin e këtij urdhëri konstatohen të njëjta problematika sikurse në urdhërin e mësipërm. Edhe në këtë rast rezulton se personat “të prekur nga urdhëri”, pa asnjë njoftim të mëparshëm zyrtar, janë vendosur në mënyrë të menjëhershme përballë kësës për kthim të shumave të pretenduara si detyrim ndaj UST, pa ushtruar të drejtën ligjore për t’u njohur me aktet, raportet, urdhrat, relacionet, përllogaritjet dhe vlerësimet juridike mbi të cilat UST mbështet pretendimin për detyrim (Neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë). Faktikisht, teksti i njoftimit për personat të prekur nga urdhëri është i njëjtë me atë të njoftimit për ata që lidhen me Urdhërin nr. 47 më lart.

Për këtë arsye, i gjithë arsyetimi juridik në lidhje me procedurën e ndjekur për ekzekutimin e këtij urdhëri është i njëjtë me atë më lart (Procedura e ndjekur për ekzekutimin e urdhërit – pika b)

Mbështetur në sa më lart, Grupi i Punës edhe për këtë procedurë ekzekutimi nxjerr përfundimet si më poshtë:

Në njoftimin drejtuar personave të prekur nga urdhëri janë anashkaluar një sërë hapash e fazash të detyruara ligjore të sanksionuara në Kushtetutën e RSH dhe Kodin e Procedurave Administrative të RSH.

Në procedurën e ndjekur gjatë ekzekutimit të Urdhërit Nr. 47, datë 15.05.2026 konstatohen një parregullsi që lidhen me mosrespektimin e disa të drejta të ligjshme të personave të prekur, duke anashkaluar edhe faza proceduriale të detyrueshme.

III – Përfundime të Grupit të Punës

Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me objektin e Vendimit Nr. nr 21, datë 14.07.2026 të Rektorit të UST “Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e procedurës së ndjekur për nxjerrjen dhe ekzekutimin e Urdhrave Nr. 47, datë 15.05.2026 “Për marrjen e masave për ndalesën e pagesave të kryera për kategorinë Asistent Lektor” dhe Nr. 62, datë 03.06.2026 “Për marrjen e masave për ndalesën e pagesave të komisioneve në zbatim të rekomandimeve të auditit të brendshëm”, Grupi I Punës nxjerrë përfundimet e mëposhtme:

A. Procedura për nxjerrjen e Urdhërave

1. *Urdhëri Nr. 47, datë 15.05.2026 “Për marrjen e masave për ndalesën e pagesave të kryera për kategorinë Asistent Lektor”*

- ✓ Urdhëri Nr. 47, datë 15.05.2026, nuk mbështetet në një vendimmarrje të BA dhe bie në kundërshtim me vendime të mëparshme Bordit të Administrimit ende në fuqi.
- ✓ Urdhëri është nxjerrë në zbatim të drejtpërdrejtë të një rekomandimi të Raportit të Auditimit të MA në kushtet e boshllëkut nënligjor të krijuar nga mosreagimi I Bordit që ka përgjegjësinë për rishikimin e kategorisë së personelit dhe pagesat përkatëse.

2. *Urdhëri Nr. 62, datë datë 03.06.2026 “Për marrjen e masave për ndalesën e pagesave të komisioneve në zbatim të rekomandimeve të auditit të brendshëm”*

- ✓ Urdhëri Nr. 62, datë datë 03.06.2026 “Për marrjen e masave për ndalesën e pagesave të komisioneve në zbatim të rekomandimeve të auditit të brendshëm” nuk mbështetet në një vendimmarrje të posacme të BA dhe në të njëjtën kohë bie në kundërshtim me vendime të mëparshme Bordit të Administrimit ende në fuqi.
- ✓ Urdhëri është nxjerrë në zbatim të drejtpërdrejtë të një rekomandimi të Raportit të Auditimit të MA në kushtet e boshllëkut nënligjor të krijuar nga mosreagimi I Bordit që ka përgjegjësinë për rishikimin e tarifave dhe pagesave të komisioneve.

3. *Roli i Bordit të Administrimit*

- ✓ Bordi i Administrimit, nuk ka nxjerrë asnjë akt nënligjor për zbatimin e Rekomandimeve të Raportit të Auditit të MA dhe Planit të Veprimit të UST në lidhje me rishikimin e kategorive të personelit dhe tarifave të pagesave, duke mos marrë përgjegjësitë dhe ushtruar kompetencat për krijimin e mbështetjes ligjore për akte nënligjore vijuese që adresojnë rekomandimin e auditit. BA duhet të vijonte me shqyrtimin e rekomandimit në lidhje me pagesat e marra nga personat që kanë fituar statusin “Lektor”, në bazë të të gjithë kuadrit rregullator në fuqi dhe në zbatim të përgjegjësiave të tij ligjore.
- ✓ Bordi i Administrimit, nuk ka nxjerrë asnjë akt nënligjor të posacëm për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Auditit të MA dhe Planit të Veprimit të UST për rishikimin e tarifave dhe pagesave të dy komisioneve të Senatit, duke mos marrë përgjegjësitë dhe ushtruar kompetencat për krijimin e mbështetjes ligjore dhe për akte nënligjore vijuese që adresojnë rekomandimin e auditit. BA duhet të vijonte me shqyrtimin e rekomandimit në lidhje me pagesat e marra nga anëtarët e komisioneve, në bazë të të gjithë kuadrit rregullator në fuqi dhe mbështetur në faktin që komisionet janë ngritur dhe kanë funksionuar në zbatim të dispozitave të Statutit të UST, miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin.

B. Procedura për ekzekutimin e Urdhërave


Nga verifikimi i kryer rezulton se, si në procedurën e nxjerrjes ashtu edhe në procedurën e ekzekutimit të Urdhërave nr. 47, datë 15.05.2026 dhe nr. 62, datë 03.06.2026, evidentohen mangësi të rëndësishme procedurale dhe të kompetencës. Për këto arsye, Grupi i Punës vlerëson se çështja duhet të trajtohet nga organet kompetente përmes rishqyrtimit të akteve dhe zhvillimit të çdo procedure të mëtejshme në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurave Administrative dhe legjislacionin në fuqi, me qëllim garantimin e ligjshmërisë, sigurisë juridike dhe mbrojtjes së të drejtave të palëve.

IV- Rekomandime të Grupit të Punës

Në përfundim, Grupi I Punës i rekomandon Senatit Akademik, t'i propozojë Bordit të Administrimit sa më poshtë:

1. Shfuqizimin e Urdhërit Nr. 47, datë 15.05.2026 "Për marrjen e masave për ndalesën e pagesave të kryera për kategorinë Asistent Lektor" nga Bordi i Administrimit, si i papajtueshëm me vendime të mëparshme të Bordit të Administrimit me të njëjtin objekt dhe me parregullsi në procedurën e ekzekutimit.
2. Shfuqizimin e Urdhërit Nr. 62, datë 03.06.2026 "Për marrjen e masave për ndalesën e pagesave të komisioneve në zbatim të rekomandimeve të auditit të brendshëm" nga Bordi I Administrimit, si i papajtueshëm me vendime të mëparshme të Bordit të Administrimit me të njëjtin objekt dhe me parregullsi në procedurën e ekzekutimit..
3. Bordi i Administrimit të ushtrojë kompetencat që i ngarkohen nga ligji, Statuti i UST-së, Raporti i Auditit dhe Plani i Veprimit, duke shqyrtuar dhe marrë vendime të arsyetuara mbi aktet që rregullojnë kategoritë e personelit, tarifat dhe pagesat dhe ato të dy komisioneve objekt verifikimi, si dhe duke garantuar që çdo ndryshim të kryhet nëpërmjet akteve përkatëse administrative dhe në respektim të parimit të sigurisë juridike.

Tiranë, më 16.07.2026



Dokumentat e bashkëngjitur

Bashkëngjitur këtij relacioni gjenden Anekset:

- Anekset 1: Dokumentacioni i përgjithshëm referuar në Pjesën Metodologjia
- Anekset 2: Dokumentacioni mbështetës për Gjetjet - *Procedura e nxjerrjes së Urdhërit Nr. 47, datë 15.05.2026*
- Anekset 3: Dokumentacioni mbështetës për Gjetjet - *Procedura e nxjerrjes së Urdhërit Nr. 62, datë 03.06.2026*
- Anekset 4: Dokumentacioni mbështetës për Gjetjet - *Plani i Veprimit të Rekomandimeve të Raportit të Auditimi të Brendshëm të MA*
- Anekset 5: Dokumentacioni mbështetës për Gjetjet - *Procedura për ekzekutimin e Urdhërit Nr. 47, datë 15.05.2026*
- Anekset 6: Dokumentacioni mbështetës për Gjetjet - *Procedura për ekzekutimin e Urdhërit Nr. 62, datë 03.06.2026*

